



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.36/2018
Prishtinë, më 11.7.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari-Lila, Memli Krasniqi, Gani Dreshaj dhe Duda Balje, anëtarë. I pranishëm ishte edhe Salih Zyba, deputet nga GP LVV-së.

Munguan: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Liburn Aliu, Glauk Konjufca, dhe Bilall Sherifi, anëtarë.

I ftuar: Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik.

Pjesëmarrës: Lulzim Demolli, Shahe Kukaj-Krasniqi, MZHE; Jalit Isufi, Sejdi Hoxha – Posta e Kosovës, Emine Shehu – Kuvendi i Kosovës; Blerta Abazi - Grupi Parlamentar Vetëvendosje; Liridon Abazi – SEEF; Gentian Berbati – KDI; Adelinë Sahiti – KTV; Suzana Bytyçi – Ekonomia Online; Sanie Isufi – Koha Ditore; Mirjeta Dervishi – Kosova Post; Visar Krasniqi – RTK dhe Majlinda Doda - Radio Kosova.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, Veton Raci dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportimi i ministrit të Zhvillimit Ekonomik z.Valdrin Lluka, në lidhje me gjendjen në Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës SHA;**
- 3. Te ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës ;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Raportimi i ministrit së Zhvillimit Ekonomik z.Valdrin Lluka, në lidhje me gjendjen në Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës SHA ;

Kryetarja, theksoi se në mbledhjet e kaluara të Komisionit është kërkuar nga deputetët që të ftohet z. Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, që të raportojë në lidhje me gjendjen në Ndërmarrjen Publike “Posta e Kosovës” SHA, si dhe përfaqësuesit e Postës, që të sqarojnë problemet financiare dhe të tjera në këtë ndërmarrje. Interesimi i deputetëve me tepër ndërlidhet me zbatimin e marrëveshjes në mes të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Postës së Kosovës, lidhur me kompensimin e shërbimeve postare universale dhe të rezervuara të ofruara nga Posta e Kosovës, por edhe për sfidat dhe problemet financiare që po kalon Posta e Kosovës. Prandaj, kërkoj nga ministri dhe përfaqësuesit e Postës së Kosovës, të sqarohen para deputetëve për këto çështje.

Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, tha se Posta e Kosovës ashtu si edhe shumica e ndërmarrjeve publike në Kosovë ka problemet e veta, kryesisht për shkak të trendëve globale, mirëpo, edhe për shkak të qarkullimit që ka pas ne vitet e fundit. Problem është edhe fakti se 80% e qarkullimit shpenzohet për paga dhe një gjë e tillë është problem sepse një luhajtje e vogël rrezikon mosrealizimin e pagave, kurse nga ana tjetër shërbimi universal postar parashihet edhe me ligj që mund të subvencionohet nga Qeveria si aksionar në këtë rast, kjo është kosto e audituar, ku vitin e fundit rreth 850.000 euro janë shpenzuar në këtë aspekt. Duke parë gjendjen në Postën e Kosovës, lidhur me pamundësinë për ti paguar pagat, kam kërkuar nga drejtori i ARKEP-it që të bëjë një vlerësim dhe të na sjellë një konfirmim të koston së shërbimit universal postar dhe pas këtij konfirmimi nga ARKEP-i, që besojmë që do ta marrim këtë javë, ne do ta sjellim në Qeveri për diskutim dhe potencialisht për subvencionim të atij shërbimi. Sa i përket tremujorit të parë të këtij viti, Posta ka rënie në shitje dhe fitim, trendi vazhdon të jetë negativ, në anën tjetër, ne kemi filluar të marrim masa në zvogëlimin e shpenzimeve në Telekomin e Kosovës dhe një ndër masat është edhe vendimi për zvogëlimin e qirave në objektet ku është Telekom i pranishëm dhe kjo ka prekur edhe Postën e Kosovës. Përmes qirasë që merr nga telekomi, aktualisht kemi rreth 4.5 milion euro që merr Posta e Kosovës nga Telekom i, apo diku rreth 40% e të gjitha të hyrave dhe automatikisht ky zvogëlim i qirave ndikon edhe në të hyrat e Postës së Kosovës. Këtë muaj bordi i Telekomit të Kosovës ka marr vendim për zvogëlimin e qirasë për 20% dhe tash jemi duke shikuar format e bashkëpunimit që të shohim mundësitë për ta ndihmuar Postën e Kosovës dhe një ndër format është edhe shpërndarja e skemave sociale dhe mundësi të tjera për ta favorizuar Postën që të sigurojë mbijetesën. Por duhet të kemi parasysh numrin e punëtoreve, rrogën mesatare, e cila aktualisht është diku 770 -780 euro dhe tash kemi një gjendje që në muajt e fundit, ka pasur probleme me realizimin e pagave dhe kjo gjendje është zgjidhur fal ndërmjetësimit tim në këtë drejtim.

Halit Isufi, kryetar i Bordit “Posta e Kosovës” SHA, tha se Posta e Kosovës që nga ndarja nga Telekom, ka trashëguar një humbje prej 3 milion euro në vit. Në vitin e parë kemi filluar zvogëlimin e shpenzimeve, duke përfshi uljen e pagave dhe si rezultat kemi arritur që në vitin 2016 dhe 2017 të operojmë me rezultat pozitiv financiar, pa llogaritur amortizimin. Kemi trashëguar vetëm dy shërbime pas ndarjes kurse deri me sot kemi lansuar disa dhjetëra shërbime të tjera, e kemi marrë licencën nga Banka Qendrore e Kosovës që të veprojmë si institucion financiare jobankar për kryerjen e shërbimeve të pagesave. Aktualisht shpërndajmë një pjesë të skemave shtetërore por kemi kapacitete të mjaftueshme për shpërndarjen edhe të skemave tjera shtetërore. Për shkak të uljes së njëanshme të pagesave për qira nga Telekom i Kosovës, kemi hasur në probleme financiare, po ashtu sfidë është edhe mosimplementimi i marrëveshjes për shërbimet universale postare.

Sejdi Hoxha, kryeshf ekzekutiv “Posta e Kosovës” SHA, theksoi se Posta e Kosovës është ndarë nga PTK-ja që nga viti 2012 dhe është themeluar si ndërmarrje publike qendrore. Si njësi biznesi brenda PTK-së, ka operuar me humbje financiare, prandaj pas ndarjes ka operuar me një humbje mujore prej rreth 300.000 euro, apo rreth 3 milion euro humbje vjetore. Duke marrë për bazë gjendjen e rendë financiare, pas procesit të ndarjes, bordi dhe menaxhmenti i ndërmarrjes kanë ndërmarrë veprime menaxheriale në reduktimin e shpenzimeve operative. Janë ulur pagat për të gjithë punonjësit, janë hequr sigurimet shëndetësore për të gjithë punonjësit si dhe shpenzime të tjera në vlerë prej 1.5 milion euro në vit. Deri në vitin 2012, në këtë ndërmarrje janë kryer vetëm shërbime bazike postare, si dhe shitja e produkteve të Telekomit dhe Valës. Ish- PTKja nuk ka investuar në zhvillimin e njësisë së Postës, për ta përmirësuar gjendjen financiare në ndërmarrjen e re bordi dhe menaxhmenti kanë ndërmarrë veprime konkrete në përmirësimin e performancës së ndërmarrjes, duke krijuar shërbime të reja dhe novatore. Shërbimi i ri kryesor është licencimi i Postës si institucion financiar jobankar, përmes të cilit kryhen të gjitha llojet e pagesave si dhe shërbime të tjera të reja, të cilat kanë ndikuar dukshëm në përmirësimin e gjendjes financiare të ndërmarrjes. Në vitin 2012 Posta ka pasur mbulueshmëri të tregut postar në Kosovë me rreth 64% kurse pas përmirësimit të shërbimeve postare që janë bërë, në vitin 2016 kemi mbulueshmëri të tregut postar në vend me rreth 96%. Në këtë treg operojnë edhe kompani postare me renome ndërkombëtare dhe kompani postare private vendore. Ligji mbi shërbimin postar obligon Postën si operator publik që të kryej shërbimin universal postar, për të ofruar këtë shërbim Posta krijon humbje vjetore prej 1 milion euro sepse obligohet në baza ditore t’i dërgojë dërgesat postare në tërë territorin e Kosovës, përfshirë vendbanimet e thella rurale. Qeveria nuk ka mbuluar humbjet financiare të Postës në ofrimin e këtij shërbimi edhe pse e ka obligim ligjor. Ne kemi kapacitete që të bëjmë shpërndarjen e të gjitha skemave shtetërore dhe kjo do të ndihmonte në përmirësimin e gjendjes financiare të ndërmarrjes.

Kryetarja, tha se ne i njohim problemet me të cilat po përballeni. Aktualisht kemi 23 skema të shërbimeve shtetërore dhe besoj se mund të shqyrtojmë mundësinë që këto shërbime ti ofrojë Posta, kur kemi parasysh se edhe çmimet e ofrimit janë me të lira dhe me të favorshme se sa ato të bankave komerciale. Me intereson ta dijtë se cilat skema të shërbimeve shtetërore ofron Posta aktualisht?

Hykemte Bajrami, theksoj se problem mbetet fakti që një ndërmarrje publike shpenzon 80% të të hyrave për paga, ndërkohë që 90% e të hyrave të saj janë nga qiraja, ku paga mesatare është 770 deri në 780 euro, pagë kjo e cila është mbi mesataren e secilit shërbyes civil në Kosovë.

Kërkoj sqarime rreth shërbimit universal postar.

Ministër ju përmendet që rreth 4.5 milion euro është qiraja që Telekomit ia paguan Postës, po ashtu përmendet që për shkak të gjendjes në Telekom, është marr vendim nga bordi i Telekomit për zbritje të njëanshme të qirasë për 20% dhe kjo automatikisht ka dëmtuar Postën e Kosovës. Si ka mundësi që kjo zbritje e qirasë të bëhet në mënyre të njëanshme. Bajrami pyeti se sa janë te hyrat e përgjithshme në raport me të hyrat e qirasë, po ashtu në një situatë kur gjendja financiare e ndërmarrjes nuk është e mirë, mendoj që numri i punëtorëve që janë punësuar vitin e fundit pra 45, nuk do të ishte fare gabim nëse nuk do të zëvendësoheshin punëtorët e pensionuar apo të cilët në forma të ndryshme kanë ndërprerë marrëdhënien e punës.

Memli Krasniqi, tha se është fakt që si edhe shumica e ndërmarrjeve të tjera publike në vend edhe Posta e Kosovës përballet me probleme të natyrës financiare. Dallimi është që menaxhmenti i Postës si asnjë ndërmarrje tjetër ka ndërmarr veprime për përmirësimin e gjendjes financiare, duke ulur shpenzimet përmes zvogëlimit të pagave etj. Normalisht që problem mbetet fakti ku në një ndërmarrje shpenzimet për paga janë 80% e të hyrave të përgjithshme dhe do të ishte me mirë që të ketë diversifikim të shërbimeve, në mënyre që të hyrat të jenë nga burime të ndryshme. Shërbimi universal postar mbetet problem që po e rëndon Postën që nga viti 2014, ku Qeveria nuk ka përmbush obligimet ndaj Postës dhe kjo po shkakton humbje tek posta me rreth 1 milion euro në vit, e që këto mjete nuk janë pak, kur shohim gjendjen nëpër të cilën po kalon Posta. Po ashtu, vendimi i Telekomit për zvogëlim të qirave është një situatë e cila nuk gjen zgjidhje por krijon probleme të tjera. Kërkoj nga ministri ta dijë se si do të silleni në raport me obligimin ndaj marrëveshjes me Postën për mbulimin e shërbimit universal postar, po ashtu a mund të shqyrtohet mundësia e favorizimit për dhënie e shpërndarjes së skemave sociale shtetërore, pasi edhe kostoja është me e favorshme dhe është absurde që këto skema t'i jepen konkurrentëve tjerë. Me intereson, a keni hapësira të pashfrytëzuara dhe a mund të gjeni forma që këto hapësira t'i shfrytëzoni dhe a jeni të fokusuar të shpërndarja e blerjeve online.

Mimoza Kusar -Lila, theksoi se është real problemi i listave për punësime, kontratat mbi vepër dhe rritja e numrit të punëtorëve, në mënyre artificiale nga partitë politike në kohë zgjedhesh. Ajo pyeti ministrin se a ka plan afatshkurtër për dalje nga kriza dhe plan afatmesëm dhe afatgjatë për ristrukturim të përgjithshëm. Sa për qind e mjeteve kanë shkuar në riaftësim, sa në markim dhe brendim të Postës së Kosovës, duke theksuar edhe problemet me vonesa të dërgesave nga ana e Postës.

Gani Dreshaj, tha se nuk mund të zvarritet shteti deri në pafundësi. Duhet sa më parë të marrim masa, në momentin që falimenton ndërmarrja duhet përgjegjësit të dalin para drejtësisë. Mendimi im është se kjo ndërmarrje dhe të gjitha ndërmarrjet tjera publike, që kanë performancë të dobët duhet të dërgohen në insolvencë. Qeveria duhet të marr masa sa më parë dhe të tejkalohen këto probleme, sa do që janë të dhimbshme.

Salih Zyba, theksoi se vonë ju ka ra ndërmend të shikoni për zgjidhjen e problemeve në Postën e Kosovës, ulja e qirasë është nga ana e Telekomit, në mënyre të njëanshme është veprim i

papranueshëm. Po ashtu, pyeti rreth masave sindikale që mund ti ndërmerrni në rast që nuk pranohen kërkesat tuaja. Zyba pyeti rreth numrit të të punësuarve në mandatin e kësaj Qeverie në Postën e Kosovës si dhe për objektet e Postës në veri të vendit.

Hykmete Bajrami, tha se sa i përket shpërndarjes së skemave sociale, a mund ta dijë saktë se sa i kushton Qeverisë shpërndarja e skemave përmes bankave komerciale dhe sa do ti kushtojë shpërndarja e tyre përmes Postës?

Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, duke u përgjigjur në pyetjet e deputeteve, tha se sa i përket humbjeve të pretenduara për shërbimin universal postar jemi duke pritur konfirmimin e ARKEP-it, për këto shpenzime. Në momentin që e kemi këtë konfirmim do ta dërgojmë në Qeveri për diskutim dhe do ti japim kahe kësaj çështje. Ajo që mund të them, është se ne do bëjmë përpjekje për ndarje të një pjese të mjeteve, por nuk mundemi që këto mjete t'i ndajmë për të gjitha vitet. Do të mundohemi që për vitin 2018 të ndajmë një pjesë kurse për vitet tjera do të gjejmë forma të tjera më vonë. Sa i përket planit afatmesëm dhe afatgjatë, një gjë që po bëhet është edhe Ligji për Ndërmarrjet Publike, i cili i obligon të gjitha ndërmarrjet publike që pas vitit të parë, pas subvencionimit duhet të futen në ristrukturim dhe të krijohen planet afatmesme dhe afatgjata që këto ndërmarrje të jenë të vetëqëndrueshme. Forma e presionit përmes përmbaruesit për tërheqjen e mjeteve, mendoj se nuk është mënyra e duhur. Duhet të ulemi dhe të gjejmë një mes të përbashkët se si të veprojmë. Sa i përket vendimit të bordit për uljen e qirasë, kjo erdhi si pasojë e gjendjes së rëndë në Telekom dhe është si masë emergjente e cila duhet të rishikohet dhe të mendohet më mirë sepse ne jemi të vetëdijshëm se ky vendim shkakton efekt negativ tek ndërmarrjet tjera.

Kryetarja, tha se është shumë më rëndësi amendamentimi i Ligjit për Ndërmarrjet Publike, dhe nevoja për ristrukturim dhe vetë qëndrim të tyre, pasi nuk është mënyra e duhur subvencionimi i tyre nga shteti dhe është barrë për buxhetin e vendit.

Sejdi Hoxha, kryeshf Ekzekutiv "Posta e Kosovës" SHA, tha se nga fillimi që prej ndarjes në vitin 2012 kemi operuar me humbje. Qysh në vitin e parë kemi pasur 300.000 euro humbje, në vitin 2013, 94% e të hyrave kanë qenë shpenzime për paga, kurse sot kemi 77% të hyrave në shpenzime për paga, që është shifër e lartë por këtë kemi mundur ta bëjmë fal uljes së pagave, heqjes së sigurimeve shëndetësore dhe kursime të tjera, e kemi rrit fitimin e ndërmarrjes. Janë pasqyrat e audituara financiare që e tregojnë këtë. Kur flasim për subvencionim, nuk e kemi fjalën për subvencionim të postës, por të shërbimit, u fol edhe për digjitalizim të shërbimit por ne kemi shumë nga institucionet si: gjykatat, prokuroritë, komunat etj., që shpërndajnë letrat përmes Postës së Kosovës, dhe saktësia e shpërndarës është 97-99%. Sa i përket besueshmërisë, sipas raportit të ARKEP-it në vitin 2013, besueshmëria në Postën e Kosovës ka qenë 74% kurse në vitin 2017, kjo besueshmëri në shërbimet tona është rritur në 96% dhe ky është treguesi më i mirë për punën tonë. Problem mbetet fakti që 40% e territorit kontrollohet nga posta e Serbisë dhe është një dëm që na shkaktohet, duke na marr pjesën e tregut tonë. Sa i përket punësimeve, ne jemi shumë transparent dhe nga numri i punëtoreve që kemi asnjë prej tyre nuk është me kontratë mbi vepër dhe sot kemi kërkesa nga postat në gjithë vendin që të rrisim numrin e punëtoreve, por për shkak të buxhetit nuk mund ta rrisim numrin e të punësuarve. Sa i përket qirave të lokaleve që kemi, janë 4.1 milion euro të hyra nga qiraja në vit, kurse të hyra të përgjithshme kemi rreth 12 milionë euro, kurse qiratë nuk mund të zgjidhen në mënyrë të

njëanshme sepse jemi palë kontraktuese dhe këtë duhet ta rishikojmë së bashku. Rreth 400.000 euro borxh është bilanci që ka posta e Kinës ndaj nesh dhe janë gjithë këta faktorë që po na dëmtojnë. Kemi disa posta të shpejta që funksionojnë ilegalisht, që me aktivitetin e tyre po na dëmtojnë. Sa i përket vonesave të produkteve online është problemi me zhdoganim të mallit dhe kjo është faktor që kemi vonesa të mallit online në shpërndarje. Sa i përket hapësirave të objekteve tona, ne shfrytëzojmë 33% të hapësirave të objekteve tona, pjesën tjetër e shfrytëzon Vala.

Kryetarja, theksoi se është mirë që jeni këtu për të raportuar dhe ti sqaroni paqartësitë që mund te ndodhin, siç ishte rasti me vonesat e arritjes së produkteve online, e ku në këtë rast problemi qëndron në vonesat që shkaktohen në Doganën e Kosovës.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni do të monitorojë punën e Ndërmarrjes Publike Posta e Kosovës SHA, përmes Ministrisë, ku do të ndikojë në dinamizmin e punës edhe të vetë ministrisë në monitorimin e ndërmarrjeve publike.

5. Të ndryshme. Çështjet vijuese.

Hykmete Bajrami, tha se sa i përket Projektligjit për Produktet e Ndërtimit, në kohën kur është bërë ristrukturimi i Ministrisë, Departamenti për Produktet e Ndërtimit ka kaluar në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, dhe ka kaluar komplet stafi atje dhe ata janë përgjegjës. Me këtë projektligj po kërkohet që të themelohet edhe njëherë ky departament në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe unë nuk mund ta përkrah një gjë të tillë.

Mimoza Kusari – Lila, tha se qëndron kjo që po e thotë znj. Bajrami, dhe kjo lëvizje e stafit është bërë në kohën kur kam qenë ministre dhe kuadër të reformës të asaj kohe, dhe premtoj se do të sjell rekomandimet kur janë bërë, se cili ka qenë qëllimi i këtij departamenti për këtë lëvizje.

Komisioni u dakordua që në mbledhjen e radhës të diskutohet lidhur me Projektligjin për produkte të ndërtimit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Sala BERISHA SHALA